



KOMUNIKATË PËR MEDIA

Regjistrimi i Partisë: *Partia e Pensionistëve dhe Invalidëve*, i hapur për shqyrtim publik

Prishtinë, 12 shkurt 2010 – “Partia e Pensionistëve dhe Invalidëve” (PPI) ka kompletuar kërkesat për regjistrim, të parashtruara nga Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vendimi përfundimtar për regjistrim të iniciativës politike do të merret pas përfundimit të periudhës 7 (shtatë) ditore, gjatë të cilës publiku mund të shqyrtoj dokumentet e regjistrimit.

“PPI” është themeluar më 03 nëntor 2009 nga z. Lush Isufaj, qëllimi i kësaj partie është promovimi i të gjitha interesave politike dhe shoqërore të anëtarësisë së vet, para së gjithash të të drejtave të pensionistëve dhe invalidëve të punës. Partia e Pensionistëve dhe Invalidëve do të angazhohet në përparimin e politikave aktuale zhvillimore ekonomike, shoqërore për standard jetësor të pëlqyeshëm. PPI ka për qëllim që Kosova të jetë e zhvilluar si shtet i një demokracie të zhvilluar në të cilën të gjithë qytetarët kanë të njëjta të drejta me obligime të barabarta para Ligjit. Për zhvillim ekonomik të vendit rëndësi do të kushtojë bujqësisë, industrisë përpunuese ushqimore, energjetikës, turizmit. Në shëndetësi do të angazhohet në përcaktimin e elementeve bazë të politikës shëndetësore e cila kishte me siguruar zhvillimin dhe përparimin e të gjitha formave të mbrojtjes shëndetësore. Për sistem modern të arsimit dhe arsimim pa pagesë në të gjitha nivelet e arsimit. PPI do të angazhohet për bashkpunim ndërkombëtar me të gjitha vendet e botës, do të bashkëpunojë dhe përkrah shoqërinë civile në vendë si dhe rëndësi do të kushtojë trashigimisë kulturore, ruajtjes së ambientit, barazisë gjinore dhe bashkpunimit me media.

Sipas Rregulles së KQZ-së nr.01/2008 për “Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike në Kosovë” *Secili mund ta kundërshtojë kërkesën në bazë të një ose më shumë arsyeve të parashtruara në nenin 5 me dorëzimin e kundërshtimeve me shkrim në Zyrë së bashku me çfardo të dhëne apo material që mbështetë kundërshtimet brenda shtatë (7) ditëve nga shpallja e kërkesës.*

Të gjitha materialet e regjistrimit duke përfshirë programin e partisë, statutin, dhe simbolin do të jenë në dispozicion për shikim dhe komente nga publiku.

Promovimi i transparencës për procesin e regjistrimit të partive politike është pjesë e procesit të KQZ-së.

Zyra për Regjistrim të Partive Politike gjendet në Rr. Agim Ramadani p.n në Prishtinë. Secili që dëshiron ti shikojë dokumentet mund të vijë në Zyrë prej orës 10-12 gjatë ditëve të rregullta të punës, nga data 12 shkurt deri më 18 shkurt 2010.

Për informatë shtesë mund të kontaktoni Zyren për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim / Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, +381 (0)38 20023006.